



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 3229/₃ Prot.

Tiranë, më 24/9 /2012

Lënda: Rekomandim për "Universiteti Egerem Çabej" Gjirokastrër.

REKOMANDIM

Nr. 24, datë 24/9/12

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Universiteti Egerem Çabej", Gjirokastrër.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr.143 datë 05/09/2012 është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Universiteti Egerem Çabej" Gjirokastrër me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi "Universiteti Egerem Çabej" Gjirokastrër për kategorinë e subjekteve të të dhënave "student".**
 - ❖ Verifikimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale, bazuar në nenet 5,6,7,8 dhe 9 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Udhëzimit të Komisionerit nr.7, datë 09.06.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit" si dhe Vendimit të Komisionerit nr.2 datë 10.03.2010 "Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre" në lidhje me:
 - Qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të njoftuar Edukim;
 - Verifikimin nëse të dhënat e kategorisë "student" përpunohen vetëm për qëllim "Edukimi" apo edhe për qëllime të tjera;
 - Verifikim i kategorive të të dhënave që përpunohen;
 - Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit, përhapjes dhe transferimit të të dhënave;
 - Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
 - Saktësinë dhe përditësimin e të dhënave personale që përpunohen;
 - Kohën e ruajtjes së të dhënave personale që përpunohen;
 - Përhapjen e të dhënave personale të mbledhura e të përpunuara, tek të tretët;
 - Transferimin ndërkombëtar të këtyre të dhënave;

- **Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave “student” bazuar në nenet 12, 13, 18 dhe 19 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në lidhje me:**
 - Informimin e subjekteve të të dhënave që ju mblidhen dhe ju përpunohen të dhënat personale dhe marrja e “pëlqimit”;
 - Rastet, nëse kontrolluesit i është kërkuar nga subjekti i të dhënave përmbushja e të drejtës për akses në përpunimin e të dhënave personale, si dhe nëse është kërkuar korrigjimi ose fshirja e këtyre të dhënave;
- **Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave personale bazuar në nenet 20, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe bazuar në udhëzimin nr.4 datë 16/03/2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit ” në lidhje me:**
 - Caktimin e ndonjë përpunuesi të të dhënave personale dhe mbi çfarë akti ligjor;
 - Vendosjen e kontrollit në aksesin e të dhënave personale të përpunuara dhe përgjegjësitë në administrimin e këtyre të dhënave;
 - Nivelin e sigurisë fizike dhe teknike të sistemit të përgjithshëm ose të veçantë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale;
 - Verifikimin, nëse ka në fuqi ndonjë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme;
 - Verifikimin, nëse janë parashikuar dhe zbatohen politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet “konfidencialitetit”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- 1) Kontrolluesi “Universiteti Egerem Çabej” Gjirokastër është në fazat përgatitore të implementimit të programeve të reja të planifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për menaxhimin e të dhënave personale të studentëve nëpërmjet aplikacioneve elektronike-informatike.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se ky moment është shumë i rëndësishëm për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe teknike për zbatimin e kushteve dhe kriterëve ligjore në respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private të subjekteve të të dhënave personale që i përkasin kategorisë “student”, është e nevojshme të respektohen kërkesat e ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Udhëzimit të Komisionierit nr.7, datë 09.06.2010 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit” si dhe Vendimit të Komisionierit nr.2 datë 10.03.2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”.

- 2) Kontrolluesi “Universiteti Egerem Çabej” Gjirokastër ka në fuqi rregulloren e brendshme të tij ku ka të parashikuar rregulla të veçanta lidhur me trajtimin, mbledhjen dhe përpunimin e dokumentacionit i cili mbart të dhëna personale, si dhe për konfidencialitetin.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj edhe në rregulloren e brendshme që është në fuqi duhet të ketë pjesë të cilat lidhen me aplikimin e këtyre programeve të reja kompjuterike të planifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në një sistem të tillë duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve (administrator, punonjës sekretarie, staf akademik, student), të drejtat e tyre, aksesit etj. Duhet të parashikohen elementët për akses të sigurt të përdoruesve, log-et për regjistrimin e veprimeve si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave (studentëve) gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Në rregullat e vendosura për procedurat e provimeve dhe shpalljes së rezultateve duhet të përcaktohen procedura të veçanta lidhur me shpalljen e tyre në mënyrë anonime, ku secili student të informohet për notën e tij, por ai dhe persona të tjerë të mos kenë mundësi të informohen për studentët e tjerë lidhur me notat që ato kanë fituar. Anonimizimi i të dhënave personale në këtë proces ka shumë rëndësi për këtë kategori subjektësh të të dhënave personale (studentë) pasi krahas informimit për rezultatet duhet të respektohet dhe privatësia e tyre.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se mungesa e marrjes së këtyre masave bie në kundërshtim me nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" ... "*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*".

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të hartohen rregulla lidhur me aplikimin e programeve të reja kompjuterike të planifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës përsa i përket:
 - Mbledhjes, përpunimit, ruajtjes dhe sigurisë të të dhënave personale për kategorinë "*student*".
 - Përcaktimit të niveleve të përdoruesve (administrator, punonjës sekretarie, staf akademik, student), të drejtat e tyre, aksesit etj.
 - Përcaktimit të kushteve për akses të sigurt të përdoruesve si dhe log-et për regjistrimin e veprimeve.
 - Përcaktimit të rregullave lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale
2. Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", në "*Rregulloren e brendshme*", të përcaktohen rregulla për mënyrën e publikimit të listave të notave të studentëve, informimin, njoftimin dhe shpalljen në mënyrë individuale dhe pa përhapje tek të tjerët. Deri në miratimin e

këtyre rregullave, publikimi i emrave dhe i të dhënave të tjera personale të studentëve në këto lista të bëhet në mënyrë të anonimizuar.

3. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", sipas të cilit... "*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

